

## PARADIGMAT” PSIKOLOGJIKE TË RRËFIMIT, NË VEPRËN DISTOPIKE“RRËFENJA E SHËRBETORES

Fatjona ABDULLAHI<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Gjuhë dhe letërsi shqipe – Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës  
e-mail: [fatjona.abdullahi@unite.edu.mk](mailto:fatjona.abdullahi@unite.edu.mk)

---

### Abstrakt

Qasja hulumtuese e romaneve distopike përqendrohet në dekonspirimin e të fshehtave të sistemeve totalitare, të qeverisjes nga udhëheqës jokompetentë, të injorancës së paraqitur nën kamuflazhin e njohurive sipërfaqësore, të mizogjinisë dhe rolit të familjes në perspektivën e femrës si qenie njerëzore dhe faktor shoqëror dhe të deluzionit të po kësaj shoqërie të dehumanizuar e të tunduar nga ëndrrat utopike të së ardhmes. Pikërisht, për shkak të analizës me karakter shumë filozofik që duhet bërë një veprë letrare distopike apo qoftë edhe një fenomeni shoqëror në dukje utopik, vënia e kufijve mes distopisë si term universal dhe distopisë si zhanër letrar, është sfidë jo tërësisht e kapërcyeshme. Megjithatë një qasje drejt distopisë feministe, kontribuon në identifikimin e dikotomisë utopi-distopi, jo vetëm në planin e pabarazisë gjinore, por edhe në atë politik e social. Veprat utopike dhe veprat distopike kanë të njëjtin funksion i cili përshkruan një shoqëri e cila ka disa parime dhe ideologji që përfaqësojnë fuqinë dhe lirinë. Kjo do të thotë që, utopia ose distopia nuk mund të identifikohet pa iu referuar këndvështrimit të lexuesit dhe se ndryshimet e dukshme midis të dyjave shoqërohen me rolin e individëve në shoqëri. Kështu, ajo që paraqet utopi për një person mund të jetë distopi e një personi tjetër, pasi rregullat brenda shoqërisë janë kryesisht të njëjta, por sërish ndryshojnë në mënyrën e ruajtjes së stabilitetit, në dhënien e lumturisë dhe heqjen e vuajtjes.

**Fjalët kyçe:** utopi, distopi, feminizëm, mizogjini, totalitarizëm, teokraci, pushtet, dije, gjuhë.

### Abstract

The research approach of dystopian novels focuses on analyzing the totalitarian systems, the incompetent government leaders, the ignorance camouflaged by the superficial knowledge, the misogyny, the role of the family from the female perspective as human being and social factor, and the delusion of the dehumanized society tempted by the utopian dreams of the future. Due to the highly philosophical analysis of a dystopian literary work or even a seemingly utopian social phenomenon, setting boundaries between dystopia as a universal term and dystopia as a literary genre is a challenge that cannot be entirely overcome. However, an approach to feminist dystopia contributes to the identification of the utopian-dystopian dichotomy, not only in terms of gender inequality, but also in political and social terms.

Both utopian and dystopian novels have the same function which is showcasing a society where certain principles and ideologies represent power and freedom. This means that utopia or dystopia cannot be identified without referring to the reader's point of view and that the differences are associated with the role of individuals in society. Thus, what constitutes a utopia for one person may be another person's dystopia, as the rules within society are mainly the same, but still differ in the way stability is maintained, happiness is given, and suffering is removed.

**Keywords:** utopia, dystopia, feminism, misogyny, totalitarianism, theocracy, power, knowledge, language.

---

### Përmbajtja

*Rrëfenja e shërbëtores* është roman distopik i projektuar në një shtet totalitar ku trupi i femrës përdoret dhe keqpërdoret në funksion të pushtetit diktatorial. Ky roman, mbetet vepër e cila përmes shprehjeve “Ka pyetje?” apo “Nolite te bastardes carborundorum!” prejjudikon të ardhmen e një shoqërie distopike totalitare në aspektin e mizogjinisë (urrejtjes, përbuzjes dhe paragjykit

ndaj femrave), në rrethana ndoshta pak më të vona se dy autorët paraprakë, por gjithsesi me të njëjtin segment shkak-pasojë si të së njëjtës kohë oruelliane kur “Lufta ishte paqe, liria ishte robëri, padituria-fuqi”. Romani përshkruan një të ardhme të qeverisur nga rregulla të rrepta fetare dhe politike.

Ngjarja është shkruar në formën autodiegetike narrative, që në ligjërimin letrar narratologjik bashkëpërkon me mishërimin e rrëfimitarit në vetën e parë me protagonistin apo heroin e ngjarjes; respektivisht në formë të tekstit rrëfimitar homodiegetik. (Prins, 2003:12).

Rrëfimitarja Efredit, evokon kujtimet e periudhës para Xhileadit, të paraqitur si dukuri analeptike (analepsis) që konsiston në anakroninë e rikthimit tek e kaluara me respekt për “momentin e tanishëm”, me ndërprerje të herëpashershme kronologjike të sekuencave të së kaluarës për t’i lënë vendin e duhur analepsës retrospektive. (Prins, 2003:17). Thënë ndryshe, shohim një rrëfimtare e cila jo vetëm që nuk na paraqitet si *horror novi* apo e tmerruar nga e reja, por shfaqet si personazhi i cili relativisht e ka përqafuar diskursin e Republikës së re të Xhileadit, në të cilin dukshëm mbizotëron *animusi* dhe shtypet *anima* jo vetëm në planin individual, por sidomos në atë kolektiv. Megjithatë, rrëfimitarja manovron me periudhën para dhe pas Xhileadit, pavarësisht se në plan të parë mënyra me të cilën përshkruan të tanishmen apo pas Xhileadit si më të mirën nga e kaluara, sërish nën hijet ironike dhe përshkrimi parodizues lë të kuptohet se jo domosdoshmërisht është pajtuar me të vërtetën që gjuha e saj xhileadike duhet ta thotë e që është se “më e mira është duke ardhur”. Ajo del si personazh që nevojën për t’iu rrëfyer adresantëve të panjohur (lexuesve) nuk e ka vetëm nevojë të brendshme shpirtërore, por edhe në njëfarë forme shprehje të revoltës apo të një diskrepance ndaj rregullores së re të Republikës së Xhileadit, sipas së cilës, askush nuk guxon ta luftojë amnezinë kolektive që pret në fund të rrugës dhe askush nuk ka të drejtë të materializojë të kaluarën nëpërmjet shënjesve gjuhësorë. Republika e Xhileadit ishte shteti fiktiv totalitar në të cilin zhvillohet ngjarja dhe imponohen rregullat e pashkruara të sistemit: “Kjo është qendra e Xhileadit, ku lufta s’mund të mbërrijë dot përveçse përmes televizionit. Kufijtë e tij nuk i dimë më siguri, ata ndryshojnë në varësi të sulmeve dhe kundërsulmeve, por kjo është qendra ku asgjë nuk lëviz. “Republika e Xhileadit, - thoshte Teto Lidia, nuk njeh kufij. Xhileadi ndodhet brenda nesh.” (Atwood, 2015:33)

Ndër çështjet më thelbësore që trajtohen në roman, është seksualiteti i gruas dhe roli i saj në shoqëri. Respektivisht, Efrediti, në fillim paraqitet si individ i cili identifikohet me të qenët femër dhe hap pas hapi, fillon ta rinjohë veten si qenie psikologjike përveçse biologjike, dhe megjithëse ky rikthim drejt vetvetes bëhet me ndihmë të reminiscencave nga e kaluara paraxhileadike, personazhi ynë rrëfimitar, deri në fund mbetet përfaqësuese e femrës, roli dhe rëndësia e së cilës prejudikohet nga funksioni dhe etiketimet që ia jep shoqëria dhe që kurrsesi nuk përkojnë me botën shpirtërore dhe intelektuale, e cila sidoqoftë është në proces destruktiv: “Ishim revizioniste dhe ajo që reviziononim qe vetvetja. Fshij fytyrën me mëngë. Dikur nuk do të kisha guxuar ta bëja nga frika se mos llangosësja, por tani nga fytyra nuk më del asgjë. Cilado qoftë pamja e saj, të cilën nuk e shoh, në fund të fundit është pamja e saj e vërtetë.” (Atwood, 2015:289)

Personazhi kryesor Efredit, mëson rregullat e lojës dhe jo rrallë shfrytëzon seksualitetin e saj për qëllimet e veta, duke shkëmbyer rolin e “lavires”, që presupozohet të jetë dhe “bartëse e shenjtë”

që shoqëria e ka paracaktuar të bëhet. Në raport me Komandantin i cili deri diku përfaqëson pozicionimin e gjinisë mashkullore në vepër, ajo shfrytëzon debulesat e tij për të jetuar apo më saktë, për të rijetuar feminitetin e vet i cili tashmë qe tkurrur deri në premisat e vezoreve dhe hiç më shumë. Emri i saj, profesioni i saj, e gjithë historia e saj janë formuar dhe diktohen nga ata që kanë pushtet mbi të. Kjo shoqëri ka marrë çdo masë paraprake për të eliminuar mendimin personal dhe të pavarur nga qytetarët; udhëheqësit e Xhileadit duken mjaft të përgatitur për t'i marrë të gjitha vendimet për qytetarët e vet dhe meqenëse Efreditit i janë dërguar mesazhe kontradiktore, ajo ka mendime kontradiktore edhe për veten e saj. Për shembull, një nga rastet e dyzimit shpirtëror është kur Komandanti e çon atë në Jezebel, një shtëpi publike e fshehtë, ku ajo kupton që është edhe e shenjtë, edhe lavire në të njëjtën kohë. Ajo është “e shenjta” që zotërohet vetëm nga Komandanti, por është edhe “lavire” sepse shfaq seksualitetin e saj publikisht. Ajo shpesh madje përdor fjalën “liri”, sikur për ta dëshmuar se është e pazotëruar. Me fjalë të tjera, ka raste kur ajo ndihet vërtet se kontrollon gjuhën, dhe nuk e kontrollon gjuha atë. Megjithatë, e vërteta është se Efrediti nuk e kontrollon dot gjuhën. Për momentin, ajo mund të jetë në gjendje të ndërtojë disa fjali të zgjedhura në një lojë, por historia e saj nuk mund të shprehet tërësisht jashtë kornizave të ligjëritit të Xhileadit. Ajo e ka kuptuar që mënyra se si e jetonin jetën, kontribuoi në krijimin e Xhileadit, meqë asokohe ajo e lejoi veten të mos vinte në dyshim mënyrën e shfaqjes dhe pozicionimit të grave, duke iu përshtatur atij imazhi vetëm e vetëm për arritje personale, gjë e cila me siguri nuk do të ishte e mundur nëse ajo do ta kishte vënë në dyshim qoftë edhe një herë "të vërtetën" rreth grave që shfaqej zyrtarisht dhe që ishte larg nga e vërteta; tani ajo e ka kuptuar peshën e asaj që dikur kishte qenë objekt kryengritjeje dhe revolte për femrat e guximshme si Moira dhe nëna e saj – peshën e fjalës së lirë, ndaj e shohim të ngashërehet: “ai ka diçka që ne nuk e kemi, ai ka fjalën. Sa dëm e kemi shkuar dikur!” (Atwood, 2015:111)

Ekzistojnë dallime befasuese midis utopisë feministe dhe Xhileadit – shëmbëlltysë së materializuar më së miri, të termit abstrakt siç është distopia. Në qoftë se në utopizmin feminist, gruaja ka mundësinë e vetëvendosjes dhe vendimmarrjes, në Republikën e Xhileadit, asaj i pamundësohet jo vetëm vendosja e aktit të mëmësisë (aborti është rreptësisht i ndaluar), por i pamundësohet edhe zbatimi i mëmësisë kur kjo të ketë ndodhur (vetëm biologjikisht) dhe fëmija i merret vetëm pas gjashtë muajsh gjidhënieje...

Nga ana tjetër, megjithëse, akti i lindjes së fëmijës konsiderohej misioni sublim i gruas, po i njëjti funksion ishte mallkimi më i madh në rrethanat kur shërbëtoret qëllonin të pafata, për të qenë enë mbajtëse në shtëpi të Komandantëve sterilë, të cilët kurrë nuk mund të cilësoheshin si të tillë, as edhe atëherë kur mundësitë fiziologjike e dëshmonin të kundërtën.

Në udhëtimet e saj psikologjike, Efredit shpesh kthehet në të kaluarën, dhe këto rikthime shërbejnë për dy qëllime. Para së gjithash, Atwood i përdor këto “fluturime” në tejkohë për të informuar lexuesit për jetën e kaluar të Efreditit, për marrëdhëniet me shoqen e saj më të mirë Moira, për nënën e saj, martesën me Lukën, dhe lindjen e vajzës së saj. Por, gjithashtu, përmes këtyre kujtimeve, marrim vizione të shoqërisë paraxhileadike. Mësojmë për mbeturinat toksike që kishin shkaktuar mungesë fertiliteti, për radikalizmin fetar etj.

Në roman, Atwood shpërfaq se si manipulimi gjuhësor është parakusht jetësor për arritjen e pushtetit, dhe kur të arrihet kjo fuqi, pothuajse çdo karakteristikë e rëndësishme e gjendjes njerëzore si kujtesa, vetëdija, shprehja, identiteti, bashkësia dhe liria, përballen me mundësinë e dëmtimit të pariparueshëm. Por, autorja tregon edhe dobitë e përdorimit të gjuhës në jetën e njerëzve, mënyrat se si gjuha rikthen kujtesën dhe ndjenjën e bashkësisë. Në fund të fundit, duke lexuar tekstin, ne fillojmë të shohim se nuk mund të ndahet gjuha nga pushteti pasi që gjuha shpesh është një mjet i pushtetit i përdorur për të shtypur dhe për të heshtur. As edhe nuk mund ta ndajmë gjuhën nga kujtesa, ngase me gjuhë ne i pranojmë kujtimet tona dhe i ndajmë ato me të tjerët.

Por, në përgjithësi, mënyra e vetme për njerëzit e kësaj shoqërie, veçanërisht për gratë, të marrin informacion, ishte të shikuarit televizion ose përmes rrjeteve të fshehta shumë të rrezikshme. Edhe pse Efrediti mendonte se "tani çdo lajm, është më mirë se asnjë", (Atwood, 2015: 105) kuptohet që lajmet në dispozicion përmes mediave ishin shumë të censuruara ose siç thotë dhe vetë ajo "ata na tregojnë vetëm fitore, asnjëherë humbje." Edhe Bibla, teksti i vetëm që do të mendohej të jetë materiali i pranueshëm për lexim, ishte i mbyllur, i nxjerrë vetëm në netët e ceremonisë dhe lexohej vetëm nga Komandantët.

Nevoja për dije dhe informacion që ka Efredit, shihet edhe në një nga takimet e saj të fshehta në dhomën e Komandantit ku në fillim, Efredit dëshiron gjëra materiale, por ndërsa takimet e tyre vazhdojnë ajo kupton se ajo që dëshiron vërtet, është dija. Ajo e sheh se nuk është duke e mësuar "të vërtetën" e vërtetë dhe kjo është më e keqja për të. Mbajtja e njerëzve në injorancë është një armë e rëndësishme për regjimin, pasi njeriu nuk mund të ushtrojë asnjë rezistencë pa dijeninë e ekzistencës së një alternative tjetër. Njohja e së kaluarës dhe informacioni, konsiderohen herezi në Xhilead për faktin se vetëm përmes dijes dhe informacionit rrezikohej absolutizmi xhileadik dhe rrëfimtarja Efredit e ka mësuar këtë fakt: "...muret janë të mbushura me raftë. Ata janë plot me libra. Libra dhe libra, dhe libra, janë të gjithë aty, pa çelësa, pa kuti. S'është për t'u habitur që nuk na lejohet të vijmë këtu. Ky është një oaz me gjëra të ndaluara. Përpiqem të mos ua ngul sytë." (Atwood, 2015:172)

Për njohje më të thelluar të rolit të gjuhës dhe përdorimit të saj në roman dhe raportit të pushtetit dhe dijes, kryesisht duhet fokusuar në diskutin e rrëfimtares që ndahet në dy etapa: në periudhën përpara dhe në periudhën pas Xhileadit. Parimet e Xhileadit janë të bazuara në shoqërinë e mëparshme. Si rezultat, ligjërimi i Xhileadit tashmë është ndërtuar para se të shfaqej, por në të njëjtën kohë është edhe diçka e re që është ndërtuar në baza të asaj që Fukoja e quan si "gjysmëheshtje". Si rrjedhojë, diskursi i Xhileadit mund të përmbajë tipare të diskursit paraprak dhe e kundërta, prandaj rrëfimi i Efreditit del paksa problematik. Ky rrëfim, sigurisht se i referohet periudhës xhileadike, megjithatë ka mbetje nga diskursi i periudhës dhe shoqërisë së mëparshme. Me lëvizjet dhe manovrimin mes këtyre dy llojeve të narracionit, zbulojmë edhe dy llojet e së vërtetës. Xhileadi vendos kufijtë gjuhësor, me censurimin e çdo fjale që ishte e ndaluar në diskutin aktual dhe me lejimin e polisemisë së fjalëve që lejoheshin në këtë diskurs. Retorika duhej përzgjedhur me standardet e një "të vërtete" të re, të ndryshme nga ajo para Xhileadit. Rezistenca bazohet në një "kauzë", e cila, në vetvete, bazohet në një "të vërtetë" të kuptueshme.

Regjimi privon Efreditin nga njohja e alternativës, pra, duke e mbajtur kështu atë brenda diskursit të vet, apo siç thotë ajo në një rast “Konteksti është gjithçka.” (Atwood, 2015:181).

Autorja është përqendruar në tema të tilla si seksualiteti, mëmësia, fuqia, nënshtrimi, kujtimi dhe harresa sepse nga dhimbja që sjell një jetë e tillë, e gjithë ekzistenca e Efreditit në Xhilead është një luftë fizike dhe psikologjike. Ajo jo vetëm që lufton për të gjetur dashuri dhe pasion aty ku në dukje nuk ekziston, ajo gjithashtu lufton të gjejë dhe të kuptojë përvojën dhe identitetin e saj. Kjo është mjaft e kuptueshme pasi gruaja është përballur me imazhe kontradiktore të vetes në çdo pikë. Por gjatë rrëfimit në roman, vërejmë se me kohë Efrediti sheh veten si qenie më të plotë dhe më pak të hutuar, që mendon dhe ndien si qenie njerëzore dhe jo vetëm si një trup që mund të burgoset, dhunohet, të përdhunohet ose të vritet. Ky zbulim i vetvetes nuk është i menjëhershëm, por ndodh përgjatë gjithë romanit gradualisht, megjithëse në fund, nuk shohim një transformim tërësor apo një triumf të pritur nga lexuesi, përpos faktit që në censurën absolute të bartjes së rrëfimit në të ardhmen, kur shkrim-leximi ishte i ndaluar, rrëfimtaria jonë arrin ta përçojë historinë e saj përmes audioincizimeve të fshehta. Në kohën kur Efrediti jetoi e që ishte koha kur sipas saj “edhe mendimi duhej racionuar”, ajo guxoi të provojë kënaqësinë e rrëfimit dhe ta luftojë me fuqitë e veta amnezinë retrograde të shoqërisë, që ishte ingranazhi kryesor i Republikës së Xhileadit për të parandaluar kujtesën kolektive dhe për të mbjellë një lloj dekadence sociale, në funksion të një rendi të ri teokratik totalitar.

## Referencat

- [1]. Adler, A. (2010), Të kuptosh natyrën e njeriut, Fan Noli, Tiranë.
- [2]. Atwood, M. (2015), Rrëfenja e shërbëtores, Botime Pegi, Tiranë.
- [3]. Aristoteli. (1998), Poetika, Prishtinë.
- [4]. Bart, R. (1989), Aventura semiologjike, Prishtinë.
- [5]. Dado, F. (2003.), Teoria e veprës letrare – Poetika, Tiranë.
- [6]. Eko, U. (1998), Struktura e papranishme, Pejë.
- [7]. Foucault, M. (1972), The Archaeology of Knowledge, New York: Pantheon.
- [8]. Frojd, Z. (1997), Ese mbi luftën dhe vdekjen, Tiranë.
- [9]. Frojd, Z. (1997), Qëndresa dhe shtypja, Tiranë.
- [10]. Hamiti, S. (2003) Utopia letrare. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- [11]. Jakobson, R. (1966), Lingvistika i poetika, Beograd.
- [12]. Jung, C. (2006), Psikologjia analitike, Fan Noli, Tiranë.
- [13]. Jung, C. (2004), Ese mbi gjurmimin e pavetëdijes, Fan Noli, Tiranë.
- [14]. Prince, G. (2003), Dictionary of Narratology, Lincoln: University of Nebraska Press.